

VENDIM
Nr. 569, datë 17.7.2019

**PËR MIRATIMIN E KOMPETENCAVE, MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE
TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT**

(Ndryshuar me vendimin nr. 165, datë 17.3.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (në vijim AKB), si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin (në vijim ministri), me seli në Tiranë.
2. AKB-ja financohet nga buxheti i shtetit, donacione të huaja dhe burime të tjera të ligjshme. Buxheti i AKB-së përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për turizmin.
3. AKB-ja ka për mision mbrojtjen dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të të gjithë potencialit ekzistues të zonës bregdetare e detare dhe pasurive mjedisore që përfshihen brenda saj, si dhe kontrollin e veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

II. KOMPETENCAT/PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT

AKB-ja ka këto kompetenca/përgjegjësi:

- a) Sigurimin e performancës në zonat bregdetare;
- b) Organizimin e punës për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- c) Organizimin e punës për nxitjen e investimeve në zonën bregdetare;
- ç) Organizimin e punës për bashkërendimin e programeve, të projekteve zhvilluese me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- d) Sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet inspektimit dhe kontrollit të veprimtarive turistike.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT

1. AKB-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në zonat, territoret, objektet e veprimtaritë që ndodhen ose zhvillohen, tërësisht ose pjesërisht, apo kanë ndikim në zonën bregdetare të Republikës së Shqipërisë.

2. AKB-ja organizohet në dy nivele:

- a) në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
- b) në nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) agjencive rajonale.

3. Ministri miraton me urdhër shtrirjen territoriale të agjencive rajonale dhe qytetin/qarkun ku do të ngrihet agjencia rajonale.

4. AKB-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson agjencinë në marrëdhënie me të tretë. Agjencitë rajonale drejtohen nga drejtuesit përkatës.

5. Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit miratohet nga Kryeministri, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

6. AKB-ja, në përputhje me kompetencat/përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:
 - a) Krijon dhe përditëson Inventarin Kombëtar të Zonës Bregdetare;
 - b) Jep kontribut në informimin, konsultimin dhe aksesin e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave e të strategjive të lidhura me menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
 - c) Merr pjesë në hartimin e politikave e të strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e tyre;
 - ç) Propozon ndryshime dhe përmirëson kuadrin ligjor e nënligjor për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
 - d) Bashkëpunon me organet përkatëse për projektet dhe aktivitetet për mbrojtjen e zhvillimin e bregdetit dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
 - dh) Nxit dhe bashkëpunon me organizma, institucione, investitorë dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë apo vendas dhe i fton ata për pjesëmarrje e përfshirje në projektet dhe zhvillimet me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
 - e) Monitoron zbatimin me përpikëri të instrumenteve të planifikimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore e vendore në zonën bregdetare;
 - ë) Kontrollon zbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
 - f) Ushtron kontroll dhe inspektion në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike;
 - g) Inspekton dhe monitoron rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare dhe respektimin e rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare;
 - gj) Inspekton dhe kontrollon zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi;
 - h) Merr masa, vendos gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit;
 - i) Shqyrton ankesat për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve;
 - j) Ndjek procesin e ekzekutimit të detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura, me qëllim arkëtimin e shumave në favor të institucionit;
 - k) Lajmëron organet shtetërore kompetente në rastet kur vërehen shkelje administrative, veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin, duke u propozuar organeve përkatëse marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës, si dhe përgatit kallëzimin penal për veprat penale të vëna re gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
 - l) Vlerëson nevojat dhe harton buxhetin vjetor e afatmesëm të institucionit;
 - ll) Siguron burimet njerëzore dhe garanton zhvillimin – trajnimin e tyre në përputhje me kërkesat e pozicionit të punës, si dhe kryen vlerësimin e performancës;
 - m) Mirëmban pajisjet dhe asetet në dispozicion për zhvillimin e veprimtarisë;
 - n) Kryen detyra të tjera të dhëna me akte ligjore dhe nënligjore.
- 6/1. Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit krijohet Komisioni i Ankimit të AKB-së, i cili drejtohet nga drejtori i përgjithshëm dhe, si rregull, ka në përbërje të tij:
- a) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për performancën dhe menaxhimin e integruar të zonave bregdetare;
 - b) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit të zonave bregdetare;
 - c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për shërbimet mbështetëse;
 - ç) nëpunësin përgjegjës për çështjet juridike/ligjore të agjencisë, në cilësinë e sekretarit të Komisionit të Ankimit të AKB-së.
- 6/2. Në mungesë të anëtarëve të komisionit të përcaktuar në pikën 6.1 të këtij kreu, për shkak të mosplotësimit të pozicionit të punës, drejtori i përgjithshëm cakton zëvendësuesin e njësisë përgjegjëse respektive, deri në plotësimin e vendit vakant.
- 6/3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Komisionit të Ankimit të AKB-së përcaktohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKB-së.

7. Agjencitë rajonale të bregdetit kryejnë këto detyra:

a) Përgjigjen para drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së për zbatimin e detyrave të përcaktuara nga drejtoria qendrore e AKB-së;

b) Bashkëpunojnë për sigurimin e informacionit për ngritjen dhe përditësimin e Inventarit Kombëtar të Zonës Bregdetare;

c) Monitorojnë zbatimin me përpikëri të instrumenteve të planifikimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore e vendore në zonën bregdetare, si dhe raportimin e situatës në drejtorinë qendrore të AKB-së;

ç) Kontrollonjë zbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;

d) Ushtrojnë kontroll dhe inspektimin në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike;

dh) Inspektojnë dhe monitorojnë rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare, dhe respektojnë rregullat për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare;

e) Inspektojnë dhe kontrollojnë zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi;

ë) Marrin masa, vendosin gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit;

f) Inspektojnë dhe kontrollojnë zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi.

8. AKB-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të marrë nga organet e tjera shtetërore, qendrore e vendore, të gjithë ndihmën dhe të dhënat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve që i janë caktuar. Institucionet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me AKB-në, të shkëmbejnë të dhëna dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë për përmbushjen e qëllimeve e të funksioneve gjatë veprimtarisë së saj.

9. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKB-së miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

10. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve të AKB-së rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

11. AKB-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e AKB-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

12. Agjencitë rajonale të bregdetit kanë stemën, logon dhe vulën e tyre zyrtare. Stema e agjencive rajonale përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Rajonale e Bregdetit... (emri i qarkut/qytetit ku ka selinë agjencia)”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Vula e AKB-së dhe vula e secilës agjenci rajonale të bregdetit kanë formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të AKB-së, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, struktura aktuale vazhdon funksionimin e saj sipas strukturës dhe organikës të miratuar.

2. Numri i punonjësve, asetet dhe fondet e miratuara për AKB-në dhe agjencitë rajonale riorganizohen sipas AKB-së, në nivel qendror e rajonal.

3. N pun sit civil  aktual  t  Inspektoratit Shtet ror t  Mjedisit, Pyjeve, Uj rave dhe Turizmit, t  cil t kryejn  funksionet e inspektimit p r kund rvajtjet administrative n  fush n e turizmit, funksione t  cilat kalojn  n  Agjencin  Komb tare t  Bregdetit, transferohen pran  AKB-s , n  zbatim t  legjislacionit t  n pun sit civil, n  rastin e mbylljes e t  ristrukturimit t  institucioneve.

4. Vendimi nr. 31, dat  22.1.2014, i K shillit t  Ministrave, “P r krijimin dhe m nyr n e organizimit e t  funksionimit t  Agjencis  Komb tare t  Bregdetit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Departamenti i Administrat s Publike p r zbatimin e k tij vendimi.

Ky vendim hyn n  fuqi pas botimit n  Fletoren Zyrtare.

KRYEMINIST R
Edi Rama